

## **Fjalim i deputetit Enkelejd Alibeaj**

26.01.2023

**Enkelejd Alibeaj** - Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të shtetit të Izraelit, Kolegë deputetë të Izraelit,

E keqja, djallëzorja, ka qenë gjithmonë e pranishme në jetët njerëzore, në shoqëritë njerëzore, pa dallim vendi, populli apo kohe. Ajo është përpjekur të hyjë herë pas here aq thellë te njeriu dhe shoqëria, sa të prekë indet më jetësore dhe t'i zhysë njerëzit, shoqëritë, familjet, komunitete të tëra në dhunë dhe në errësirë, në dhimbje dhe në vuajtje, në tmerre, të cilat është vështirë të përshkruhen. Holokausti, Shoah, është krimi i përbindshëm ndaj popullit hebre, është një nga këto të këqija të patregueshme, dëshmi e faktit se djallëzorja mund të arrijë në pika të pamendueshme.

Holokausti, ky krim lebetitës ndaj një populli të tërë, ky krim i llahtarshëm që nuk kurseu as fëmijë dhe as gra, as pleq dhe as të sëmurë, është dëshmi e faktit se djallëzorja mund të marrë forma të tilla të pamendueshme.

Holokausti është dëshmi e faktit se si një grupim politik, se si një ide e çmendur e veshur me politikë, mund të organizohet, mund të ecë, të rritet dhe të shfaqë veten sikur të jetë normale, e pranueshme, e vlefshme. Kjo ide politike, kjo filozofi kriminale, kjo ideologji fondamentaliste, që propozon haptas zhdukjen dhe shfarosjen e një populli, mori jetë në sytë e të gjithë botës dhe u rrit përballë indiferencës.

Holokausti është dëshmi e faktit se si një ideologji politike që e shikon zgjidhjen tek shfarosja e një populli, që e shikon legjitimimin e saj tek sajimi i kompleteve, që flet pa ndalur për armiq dhe që shikon kudo armiq, mund të arrijë të bëhet një makineri gjakësore dhe vrastare, që ndërton kampe dhe dhoma gazi për të zhdukur një popull të tërë. Ai është dëshmi e faktit se si një ideologji paranoitale, se si projektimi i çdo faji, i çdo të keqeje tek tjetri, mund të prodhojë krime të tilla të mynxyrshme si dërgimi në dhoma gazi dhe në kampe zhdukjeje të një populli të tërë.

Holokausti e nisi në fillim duke dehumanizuar hebrenjtë, duke i cilësuar ata si e keqja, duke shpikur komplete, duke përdorur të gjithë denigrimin dhe poshtërimin që mendja njerëzore mund të pillte. Ata u quajtën racë dhe një popull pa identitet fetar dhe kulturor; ata u quajtën një racë që si tuberkulozi, përhapet dhe infekton; ata u quajtën insekte e kështu me radhë. Më pas u dogjën sinagogat dhe shtëpitë, nisi dhuna, internimi, vrasja dhe kampet, dhomat e gazit dhe krematoriumet.

Për ne shqiptarët, kjo është një histori e përjetuar dhe shumë e ngjashme me atë që ka ndier gjatë komunizmit i gjithë ky popull.

Holokausti është për botën dhe të gjithë ne një dhembje që nuk mbaron. Ne shqiptarët e njohim mirë këtë lloj dhembjeje. Ne e dimë se çfarë mund të bëjë një ideologji e çmendur totalitare; ne e dimë se çfarë do të thotë dehumanizim; ne e dimë se çfarë do të thotë dhunë dhe gjenocid, ne e dimë se çfarë sjell një politikë që shikon kudo armiq, që është paranojake, që e shikon zgjidhjen tek asgjësimi dhe te zhdukja e tjetrit.

Kampet famëkeqe të shfarosjes, llahtaritë që pa bota në *Mathausen*, në *Aushvitz*, në *Birkenau*, në *Dakau*, lotët dhe regëtimat e shpirtit njerëzor në këto kampe janë dhe do të mbeten gjithnjë një pjesë e rëndë e historisë së qenies njerëzore, siç do të mbeten edhe një barrë e pashkulshme nga ndërgjegjja njerëzore.

Primo Levi, një i mbijetuar i kampeve të shfarosjes, thotë se ato nuk ishin kampe zhdukjeje apo kampe pune, ato nuk ishin kampe vrasjeje apo kampe vuajtjeje, por kampe të shkatërrimit të njeriut. Në të vërtetë Holokausti, kampet dhe ajo që ndodhte në to ishin vërtet kampe të shkatërrimit të njeriut. Në to qenia njerëzore reduktohej thjesht në një skelet dhe pak mish të gjallë, e njeriu zhvishej nga çdo element që e bën atë njeri, i hiqej çdo gjë që Zoti ia ka dhënë qenies njerëzore në mënyrë që ajo të jetë vërtet krijesa e zgjedhur e Zotit. Ne shqiptarët e njohim mirë këtë gjendje, sepse kemi parë kampet e Spaçit, të Tepelenës apo të Maliqit.

Ne kujtojmë sot Holokaustin për të nderuar viktimat, për të përjetësuar vuajtjet dhe dhembjet e tyre, për të reflektuar mbi ato dhembje dhe vuajtje. Ne përkujtojmë sot Holokaustin për të treguar se plagë të tilla nuk mbyllen kurrë. Ato thjesht mbulohen nga mendja njerëzore me një membranë, në mënyrë që të mbrojmë jetën dhe njeriun.

Ne e kujtojmë Holokaustin për të treguar se liria, siç thoshte presidenti Regan, është vetëm një brez larg zhdukjes. Ajo nuk duhet të merret e mirëqenë, për të duhet luftuar përditë. Nazizmi, si dhe komunizmi, erdhi dhe mori jetë lirisht, pa e kuptuar.

Shkrimtari i madh hebre Eli Vizel, fitues i Çmimit Nobel dhe i mbijetuar i Holokaustit, thotë se gjëja më e rrezikshme nga të gjitha është indiferenca. Ai thotë se kur dikush të sulmon, të lufton, të shan, mund të të motivojë të luftosh, të mbrohesh, të ndërtohet një mekanizëm apo diçka të vlefshme. Kur dikush është indiferent, kjo do të thotë se ai nuk bën diferencën, nuk bën dallimin e të mirës nga e keqja, nuk përfshihet në anën e asnjërës, pra nuk përfshihet në anën e së mirës dhe kështu e keqja fiton.

Eli Vizel thotë se nazizmi lindi, u rrit, kreu krimet nga indiferenca. Ai humbi, u poshtërua dhe u gremis nga angazhimi i botës në anën e të mirës. Kjo është arsyeja pse ne kujtojmë me shumë

emocion, me shumë dhembje dhe me shumë reflektim ditë si Holokausti. Kongresmeni Tom Lantosh mbante me vete në zyrën e tij në kongres një copë teli me gjemba nga kampet naziste të shfarosjes, ku ai kishte vuajtur dhe kishte mbijetuar. Ai ishte për dekada me radhë një simbol i lirisë dhe gjithmonë përmendte nevojën e kujtesës, reflektimit, dëgjimit të ulërimave të dhembjes, në mënyrë që kurrë më të mos ndodhin krime të tilla.

Faleminderit!